

mijëve në transmetim
e Autoritetit të M
që prej muajit prill
më Buletini i shumë
dime Këshillit të pë
ave kanë Ankesave.
vejtë të kërkojë, të he
arrë dhe të ndajë inf
ide, pa asnjë lloj cen
, të dhe mjeteve të tj
it audioviziv apo nd
tër bazuar në përzgje



AUTORITETI I
MEDIAVE
AUDIOVIZIVE

NR. 7



Prill 2021
© AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE



AMM



AUTORITETI
MEDIAE
AUDIOVISIVE

Dürmbajtje

A decorative graphic consisting of two thin red lines. One line starts at the bottom left, goes diagonally up to the right, then horizontally to the right, then diagonally down to the right, and finally vertically down to the bottom right. The second line starts at the bottom left, goes diagonally up to the right, and then vertically down to the bottom right. This creates a large, open, stylized shape that resembles a 'D' or a similar letter.

Në vend të hyrjes 4

SEKSIONI 1

Ankesa me subjekt "Cenim i rregullave të etikës dhe dinjitetit" 8

SEKSIONI II

Ankesa me subjekt "Cenim i të drejtave të fëmijëve". 26

SEKSIONI III

Ankesa me objekt të ndryshëm..... 32

SEKSIONI V

Ankesa të rrëzuara..... 42

Në vend të parathënjes



Mbrojtja e të dhënave personale në raportimin e lajmit mbetet ende sfida e medias në misionin e saj për raportimin e çdo informacioni në interes të opinionit publik. Ligji nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Kodi i Transmetimit, miratuar nga AMA, detajon parimet themelore lidhur me respektimin e normave morale dhe etike në programet audiovizive. Gjashtë mujori i dytë i vitit 2019, të cilit i dedikohet Buletini nr.7 i Këshillit të Ankesave, përmban disa ankesa lidhur me çështjen e publikimit të të dhënave të ndjeshme që cënojnë dinjitetin dhe të drejtat themelore të njeriut, përfshirë këtu edhe të miturit. Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive është një strukturë që mbikëqyr zbatimin e Kodit të Transmetimit të miratuar nga AMA sa i përket dinjitetit e të drejtave të tjera themelore të njeriut, në mënyrë të veçantë mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, të të drejtës për informacion dhe sensibilizimit të opinionit publik lidhur me respektimin e normave morale dhe etike në programet audiovizive. Cështja e publikimit të të dhënave sensitive të fëmijëve ka qenë dhe mbetet një shqetësim i vazhdueshëm në trajtimin e ankesave me përmbajtje të tillë nga Këshilli i Ankesave, prandaj edhe në këtë buletin, bazuar edhe mbi

ankesat e ardhura me këtë përmbajtje, janë publikuar më së shumti shqyrtime ankesash ku pretendohet se cenohet dinjiteti i të miturve e kryesisht të të miturve, viktima të abuzimit. Këshilli i Ankesave vlerëson maksimalisht misionin informues të Medias në interes të opinionit publik lidhur me ngjarjet që ndodhin por shpesh gjatë raportimit në emër të së vërtetës dhe të paanshmes është vënë re se janë cënuar disa parime dhe norma etike që kanë ndikuar negativisht te personi i prekur. Ankesat e trajtuara në këtë buletin i janë nënshtruar procedurës së ndërveprimit mes Këshillit të Ankesave dhe ofruesit të shërbimit mediatik audioviziv (OSHMA), sipas udhëzimit “Mbi procedurat e trajtimit të ankesave nga ofruesit e shërbimit mediatik audioviziv (OSHMA)” miratuar në maj 2018. Ky bashkëpunim mes Këshillit të Ankesave dhe Bordeve të Shqyrtimit të Ankesave të OSHMA –ve, jo vetëm është reflektuar në zgjidhjen e shpejtë të ankesave duke ndihmuar gjithë procesin e shqyrtimit por përfshirja e OSHMA-së ka bërë të mundur sensibilizimin e operatorëve audiovizivë mbi njohjen dhe zbatimin e normave dhe kërkesave ligjore të Kodit të Transmetimit dhe Ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Seksioni



ANKESA ME SUBJEKT

“CENIM I RREGULLAVE TË ETIKËS DHE DINJITETIT”

Ankesa e paraqitur nga: **N.A.**

Subjekti audioviziv

"Ora News"

Programi

"Boom"

Data

29.07.2019

1. Përmbledhje e ankesës

Ankuesi pretendon se në emisionin "Boom", transmetuar në televizionin "Ora News" është shkelur neni 33 i Ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Pas marrjes së ankesës, Këshilli i Ankesave pranë AMA-s nisi shqyrtimin e saj duke i dërguar një shkresë Televizionit Ora News mbi respektimin e të drejtës së përgjigjes. Në përgjigjen dërguar Autoritetit të Mediave Audiovizive, Shoqëria "Ora" sh.a., vuri në dukje se ajo çfarë është transmetuar në emisionin "Boom" i referohet dokumentave ligjore, të dhënave zyrtare si dhe dëshmime me zë dhe figurë të artistëve të cilët kanë denoncuar fenomenin e mbledhjes se parave për veprat e përdorura që kanë lidhje me të drejtat e autorit. Pas shqyrtimit me kujdes të emisionit investigativ Këshilli i Ankesave pranë AMA-s, nuk konstatoi shkelje të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar dhe të Kodit të Transmetimit. Raportimi i rastit në fjalë, ka qënë korrekt dhe i drejtë për të gjithë subjektet e interesuar dhe është bazuar mbi dokumente ligjore dhe zyrtare si dhe mbi deklaratat e realizuara me zë dhe figurë të artistëve të intervistuar.

Ankesa e paraqitur nga: **N.Ç**

Subjekti audioviziv

"Top Channel"

Programi

Edicionet Informative

Data

14.06.2019

1. Përmbledhje e ankesës

Ankuesi pretendon se në një kronikë të transmetuar në televizionin "Top Channel", është prekur reputacioni i tij dhe kompanisë që ai drejton bazuar në shpifje dhe mashtrime nga individë të implikuar për interesa të një televizioni.

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave nisi shqyrtimin duke i kërkuar Televizionit "Top Channel" paraqitjen e pretendimeve lidhur me ankesën. Përmes një përgjigje Top Channel deklaroi se në edicionet informative është transmetuar ankesa e një qytetari pasi ky i fundit ka vendosur në dispozicion edhe dokumentet si deklaratë noteriale. Pas shqyrtimit të materialit filmik, Këshilli i Ankesave vlerësoi se raportimet gjatë edicionit informativ janë brenda parimeve të Kodit të Transmetimit dhe nuk konstatoi shkelje të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Ankesa e paraqitur nga: **Kryesisht**

Subjekti audioviziv

"News 24"

Programi

"Me zemër të hapur"

Data

04/07/2019

1. Përmbledhje e ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive ka vëzhguar transmetimin e një video në emisionin "Me zemër të hapur ku shfaqet dhuna ekstreme e bashkëshortit ndaj bashkëshortes së tij, në prani të dy fëmijëve të cilët vëzhgojnë dhunën dhe reagojnë në mënyrë traumatizuese.

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Pas këqyrjes së materialit filmik, Këshilli i Ankesave evidenton se fëmijët janë të identifikueshëm nga prania e të afërmeve në studio apo në lidhje telefonike, ndonëse pamjet janë të mbuluara. Ligji organik edhe Kodi i Transmetimit parashikojnë si detyrim që OSHMA-të jenë shumë të kujdesshëm në raportimet apo transmetimet e tyre, kur në to janë të përfshirë të mitur. Këshilli i Ankesave evidenton se transmetimi i videos ku të pranishëm janë dy fëmijë, përbën shkelje të Kodit të Transmetimit dhe mund të sjellë pasoja afatgjatë psikologjike për fëmijët e përfshirë. Në Seksionin 5 të Kodit të Transmetimit,

"Fëmijët në transmetimet audiovizive", pikat 5.1 dhe 5.2, përcaktohet qartë se: "OSHMA-të duhet të shmangin çdo raportim apo transmetim, që çon direkt apo indirekt në identifikimin me pamje dhe zë, me gjeneralitete, adresë apo përshkrues të çdo fëmije që mund të jetë ose është viktimë, dëshmitar, i hetuar, i akuzuar apo deklaruar fajtor për kryerjen e një vepre penale", si dhe "Duhet shmangur çdo raportim apo transmetim që çon direkt apo indirekt në identifikimin e çdo fëmije që mund të jetë ose është përfshirë në një ngjarje të rëndë familjare".

Këshilli i Ankesave kërkoi nga OSHMA-ja ndërprerjen e transmetimit të videos ku të miturit janë të ekspozuar rëndë ndaj dhunës dhe identifikohen në mënyrë të tërthortë si dhe heqjen e pamjeve nga kanali zyrtar në "You tube" apo rrjetet sociale.

Ankesa e paraqitur nga: **A.A.**

Subjekti audioviziv

"TV Klan"

Programi

"Stop"

Data

17/09/2019

1. Përmbledhje e ankesës

Ankuesi pretendon se në emisionin "Stop" është shkelur "kodi i etikës dhe janë cënuar pa të drejtë morali, nderi, dinjiteti dhe të drejtat e personave".

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Pas marrjes së ankesës, Këshilli i Ankesave nisi trajtimin e saj. Bazuar në nenin 51 të ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, rregullores "Mbi procedurat për shqyrtimin e ankesave nga Këshilli i Ankesave dhe të drejtës së përgjigjes", si dhe udhëzimit "Mbi procedurat e trajtimit të ankesave nga Ofruesit e Shërbimit Mediatik Audioviziv", Këshilli i Ankesave i kërkoi televizionit "Klan" paraqitjen e pretendimeve lidhur me ankesën. Pas paraqitjes së pretendimeve përkatëse dhe në vijim të shqyrtimit të ankesës, Këshilli i Ankesave konstatoi se:

- Çështja e trajtuar nga emisioni investigative "Stop" përbënte interes publik;
- Kodi i Transmetimit për mediat audiovizive, i miratuar nga AMA, për rastet e të dhënave personale, në pikën 3.2 të tij përcakton se: "... shpërndarja e informacionit tek

publiku është e pranueshme vetëm nëse një interes i ligjshëm publik tejkalon të drejtën për privatësi ose kur materiali në fjalë duhet të publikohet në interes të publikut, duke tejkaluar të drejtën e privatësisë".

- Po sipas Kodit tëv Transmetimit, interesi publik përfshin zbulimin ose ekspozimin e krimit apo padrejtësisë serioze, gjë që përputhet me materialin e transmetuar gjatë emisionit "Stop".
- Emrat e pedagogëve të tjerë janë të panjohur deri në momentin që pedagogu D.H. i përmend, duke treguar faktin, se si do të ndërhynte për të zgjidhur punën me ta. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, në vendimet e saj, ka përcaktuar qartë dallimin midis atyre që i quan fakte dhe gjykimeve vlerësuese (opinioneve, mendimeve). Në rastin konkret, ekzistenca e fakteve mund të dëshmohej lehtësisht nga videot e transmetuara, ku nëpërmjet fjalëve të pedagogut pasqyrohet mekanizmi i marrjes së provimeve;

Bazuar sa më sipër, Këshilli i Ankesave nuk konstatoi shkelje të normave ligjore dhe etike.

Ankesa e paraqitur nga: **A.A.**

Subjekti audioviziv

ABC News

Programi

Edicion Informativ

Data

07/09/2019

1. Përmbledhje e ankesës

Ankuesi pretendon se në edicionet informative të ABC News janë transmetuar kronika që paraqesin disa turistë nudo duke thyer rregullat e etikës dhe Kodin e Transmetimit.

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave shqyrtoi me kujdes materialin filmik dhe konstatoi se kronika e lajmeve trajtonte shqetësimin se një plazh publik po përdorej në mënyrë të paligjshme si plazh nudist në Shqipëri, dhe në këtë rast, çështja e trajtuar paraqet interes publik. Kronika trajtonte një dukuri që ende nuk është rregulluar me ligj dhe apelonte për ndërhyrjen e strukturave përkatëse shtetërore. Këshilli i Ankesave vlerësoi se pamjet ilustruese janë transmetuar të mbuluara, ashtu siç e parashikon edhe Kodi i Transmetimit për mediat audiovizive.

Ankesa e paraqitur nga: **B.Sh**

Subjekti audioviziv _____

Report TV

Programi _____

Emisioni "Repolitix"

Data _____

03.10.2019

1. Përmbledhje e ankesës

Ankuesja pretendon se media audiovizive publikoi pamje të rënda të trupit të një individi të vrarë. Sipas pretendimit të saj, pamjet janë në shkëlqje të rëndë të etikës dhe të dinjitetit të viktimës e familjarëve të tij.

Gjatë emisionit u publikuan nga të ftuarit detaje të ngjarjeve të ndodhura në kontekstin e një emisioni që transmetohet drejtpërdrejt dhe, gjithashtu edhe të interesit publik. Megjithatë, vlerësojmë se detaje të tilla edhe mund të shmangen, pa cenuar qëllimin e emisioneve;

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) shqyrtoi me kujdes materialin filmik në emisionin përkatës.

Pas shqyrtimit të emisionit "Repolitix", të transmetuar drejtpërdrejt (live) në "Report Tv", mbrëmjen e 1 tetorit 2019, u konstatua se:

Emisioni, me titullin "Kalvari i vrasjeve në Lushnjë", trajton ngjarjet e fundit kriminale me pasoja të rënda në qytetin e Lushnjës. Të ftuarit komentojnë rrethanat e ngjarjeve të ndodhura, ngjarje me ndikim jo vetëm për zonën e Lushnjës, por dhe më gjerë, e për pasojë, këto ngjarje bartin edhe interes publik.

Këshilli i Ankesave do të ndjekë nga afër emisionet që transmetohen në mënyrë të drejtpërdrejtë, për të analizuar përmbajtjen e tyre dhe për t'u kujtuar operatorëve audiovizivë zbatimin e kërkesave ligjore dhe etike, që rrjedhin nga ligji nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe nga Kodi i Transmetimit për mediat audiovizive.

Ankesa e paraqitur nga: **A.A**

Subjekti audioviziv

Top Channel

Programi

Edicioni informativ

Data

04.10.2019

1. Përmbledhje e ankesës

Akuesi pretendon se media audiovizive publikoi pamje të rënda të trupit të një individi të një individi të vrarë. Sipas pretendimit të tij, pamjet janë në shkelje të rëndë të etikës dhe të dinjitetit të viktimës e familjarëve të tij.

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive shqyrtoi pamjet filmike në edicionin informativ të datës 04/10/2019, ora 15:00 transmetuar në televizionin "Top Channel", ku sipas ankesës, janë transmetuar fotografi me pamje të rënda që mund të kenë prekur ndjeshmërinë e opinionit publik. Këshilli i Ankesave, pasi shqyrtoi materialin filmik në fjalë, konstatoi se kronika e transmetuar nga Top Channel pasqyron një aksident të ndodhur në afërsi të

Vorës si pasojë e të cilit një person ka përfunduar në kanal in anësor të rrugës duke humbur jetën.

Këshilli i Ankesave pranë AMA-s vëren se ngjarja e ndodhur, e cila përbën interes publik është raportuar me korrektësi nga Top Channel ndërsa nuk konstaton transmetimin e pamjeve të papërshtatshme në kronikë. Këshilli i Ankesave nuk konstatoi shkelje të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar dhe as të Kodit të Transmetimit. Gjithsesi, monitotimi i vazhdueshëm i përmbajtjeve audiovizive në respektim të ndjeshmërisë së publikut në rastet e fatkeqësive, katastrofave, aksidenteve, etj mbetet prioritet i Këshillit të Ankesave në zbatim të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar dhe të Kodit të Transmetimit për mediat audiovizive.

Ankesa e paraqitur nga: **Qendra e Bashkuar pro kauzës LGBT – pro LGBT**

Subjekti audioviziv _____

Programi _____

Data _____

Ora News

Emisioni 360 Gradë

18.10.2019

1. Përmbledhje e ankesës

Organizata Qendra e Bashkuar pro kauzës LGBT – pro LGBT pretendoi se në emisionin “360 gradë” është përdorur gjuha e urrejtjes ndaj komunitetit LGBT.

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive i kërkoi televizionit Ora News të japë pretendimet mbi këtë ankesë.

Me dhënien e pretendimeve, Këshilli i Ankesave, pasi zhqyroi pamjet filmike të emisionit të transmetuar, konstatoi shkelje të ligjit nr.97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe të Kodit të Transmetimit për mediat audiovizive.

Shkeljet u konstatuan gjatë deklaratave të të ftuarit në emision, Kujtim Gjuzi, i cili në debat e sipër me të ftuarit e tjerë, Elton Ilirjani dhe Altin Hazizaj, përdori fjalor të rëndë fyes dhe gjuhë urrejtjeje duke cënuar ligjin dhe parimet e Kodit të Transmetimit.

Konkretisht, në pjesën e debatit të Z. Gjuzi me Z. Ilirjani, citohet: “Po çka kërkon ky tani, se s’di as si t’i them... zonjë, zonjushë, a zotni se ca me i thënë këtij tani...ky do dhe të kuq buzësh...e ke parasysh. Ne mbrojmë Ali Pashë Tepelenën këtu, se e akuzojnë disa artikullshkrues se përdorte prapanicën, dhe ti më del nga Tepelena me prapanicë përsprapthi. E kupton se ku je ti apo jo?...Ti kërcënon familjen...ti dhe

grupi LGBT jeni rrezik për familjen dhe shoqërinë...prandaj ke ikur sepse s'ke vend në Tiranë...Jeni diarre komplet”

Gjatë emisionit, ndërhyrja e drejtuesit të emisionit ishte e pamjaftueshme për të ndaluar këtë gjuhë të papërshtatshme, pasi ndërhyrja me këtë gjuhë u vu re disa herë gjatë emisionit të drejtpërdrejtë.

Ligji nr.97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar në nenin 33 të tij detyron OSHMA-të “të mos cenojnë dinjitetin dhe të drejtat themelore të njeriut”.

Gjithashtu në nenin 32, në pikën 4 përcaktohet shprehimisht se “OSHMA-të nuk transmetojnë programe me përmbajtje që të nxisin urrejtjen mbi baza racore, gjinie, fetare, etnike, kombëtare dhe çdo forme tjetër diskriminimi.”

Në Kodin e Transmetimit, në seksionin 1 “Parimet Themelore”, pika 1.5 përcaktohet se “Transmetimet audiovizive nuk duhet të nxisin urrejtjen, intolerancën, diskriminimin ose të justifikojnë dhunën ndërmjet shtetasve” ndërsa në seksionin 4 “Transmetimi i programeve informative”, pika 4.8 përcakton se “Transmetimet audiovizive informative nuk duhet të përmbajnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të

nënkuptojnë mesazhe diskriminuese për shkaqe si: gjinia, raca, mosha, ngjyra, etnia, gjuha, identiteti gjinor, orientimi seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore ose çdo shkak tjetër”

Nisur nga më sipër, Autoriteti i Mediave Audiovizive i tërheqi vëmendjen televizionit dhe rikujtoi se çdo shkelje e ligjit nr. 97/2013 “Për transmetimet audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe e Kodit të Transmetimit ndërshkohet me gjobë.

Ankesa e paraqitur nga: **A.A**

Subjekti audioviziv _____

ABC News

Programi _____

Edicioni informativ

Data _____

09.10.2019

1. Përmbledhje e ankesës

Ankuesi pretendon se media audiovizive ka transmetoi një kronikë informative në të cilën shfaqeshin individë (turistë) nudo në një nga plazhet publike të vendit.

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) shqyrtoi me kujdes materialin filmik dhe konstatoi se:

Kronika e lajmeve trajton shqetësimin se një plazh publik po përdoret në mënyrë të paligjshme si plazh nudist në Shqipëri, dhe në këtë rast, çështja e trajtuar paraqet interes publik. Kronika trajton një dukuri që ende nuk është rregulluar me ligj dhe apelon për ndërhyrjen e strukturave përkatëse shtetërore. Pamjet ilustruese janë transmetuar të mbuluara, ashtu siç e parashikon edhe Kodi i Transmetimit për mediat audiovizive.

Ankesa e paraqitur nga: **Inicuar**

Subjekti audioviziv

Programi

Data

Të gjithë

Edicionet informative

12.10.2019

1. Përmbledhje e ankesës

Në datë 10.10.2019, rreth mesnatës, në qytetin e Kavajës ku mbeti i varrë një person dhe një tjetër u plagos. Këshilli i Ankesave, për shkak të shqetësimeve të shumta, vizioi kronikat raportuese, përfshirë dhe lidhjet direkte, në këto televizione:

- Top Channel
- TV Klan
- Vizion Plus
- News 24
- Televizioni A2
- ABC News
- Fax News
- Ora News
- Report Tv

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Nga vizionimi i tyre rezultoi se:

Të përbashkëta në të gjitha raportimet ishin:

- Pamjet e jashtme të banesës ku ndodhi ngjarja
- Pamje të brendshme të banesës;
- Fotot profil të prognistëve të ngjarjes (me përjashtim të Top Channel, ABC News dhe televizionit A2)
- Shenjat e plumbave
- Detaje mbi rrethin, lagjen dhe të dhëna të tjera për protagonistët dhe familjarë.

Nga raportimet e secilit televizion u kontaktua:

Top Channel

- Jepen pamjet e gjakut, të retushuara
- Nuk jepet pamje e personit të varrë.

Tv Klan

- Jepen pamjet e gjakut, të retushuara
- Jepet pamje e personit të varrë, e retushuar.

Vizion Plus

- Jepen pamjet e gjakut, të retushuara
- Nuk jepet pamje e personit të varrë.

News 24

- Gjatë kronikës informative jepen pamje të gjakut të retushuara
- Gjatë raportimit live këto pamje janë të paretushuara.
- Jepen pamje të personit të vvarë, të retushuara.

A2

- Nuk jep as pamje të gjakut, as të personit të vvarë.

ABC News

- Jepen pamje të personit të vvarë, të retushuara
- Jepen pamje të gjakut, gjithashtu të retushuara.

Fax News

- Jepen pamje të personit të vvarë, të retushuara
- Pamje të gjakut, të retushuara.

Ora News

- Jepen pamje të personit të vvarë, të retushuara
- Jepen pamje të gjakut, të paretushuara.

Report TV

- Jepen pamje të njollave të gjakut, të paretushuara
- Nuk jepet pamje e viktimës.

Këshilli i Ankesave pranë AMA-s vëzhgoi të gjitha raportimet e deritanishme mediatike mbi këtë ngjarje dhe konstatoi se, në disa raste ka patur publikim të panevojshëm të të dhënave personave, si dhe transmetim të pamjeve të rënda, pa përdorur teknologjinë e përshtatshme që mundëson fshehjen e identitetit me pamje ose me zë, sipas përcaktimeve në Kodin e Transmetimit për mediat audiovizive. Konkretisht, në disa kronika informative janë publikuar identitetet e personave të përfshirë në këtë ngjarje, përfshirë dhe të nënës së tre fëmijëve. Po ashtu, janë dhënë detaje të tjera të panevojshme që lidhen me familjarë të saj. Pamjet e transmetuara brenda banesës ku ndodhi ngjarja, në disa raste janë të pambuluara, siç parashikon Kodi i Transmetimit.

Bazuar sa më sipër, megjithëse publikimi i këtij lajmi përbën interes të veçantë për opinionin publik, ai shkel parimet e sanksionuara në Kodin e Transmetimit. Raportimi i hollësishëm

i këtyre akteve të rënda më shumë se sa flet për ngjarjen, shton dhimbjen që ato lënë pas, duke përbërë kështu dhe shkelje të etikës në gazetari.

AMA risolli në vëmendje se, Kodi i Transmetimit, seksioni 3 ka për qëllim të sigurojë të drejtën për privatësi dhe mbrojtjen e të dhënave personale. “Përveç rasteve me interes të lartë publik, OSHMA-të nuk duhet të transmetojnë imazhe apo fotografi të individëve të arrestuar në pranga, pa miratimin e tyre paraprak. OSHMA-të duhet të respektojnë veçanërisht të drejtën e individëve për privatësi kur raportojnë mbi grupet e pambrojtura të popullatës, apo mbi situata kur ka ndodhur ndonjë tragjedi, sëmundje apo shqetësim.... OSHMA-të nuk duhet të bëjnë publike identitetin e personave që kanë humbur jetën, apo që janë përfshirë nëpër aksidente, përveç rasteve kur OSHMA-të kanë konfirmuar se anëtarët e familjeve të tyre janë informuar dhe janë të vetëdijshëm për situatën” (pika 3.3).

Pavarësisht se disa operatorë audiovizivë kanë raportuar në mënyrë korrekte ngjarjen në fjalë, duke zbatuar parimet ligjore dhe etike, në raportime të

tjera konstatojmë se ka patur përsëritje të tepruar të pamjeve, detajeve dhe të dhënave të tjera për ngjarjen dhe personave të përfshirë në të.

Sa më sipër Këshilli i Ankesave në Autoritetin e Mediave Audiovizive risolli për të gjitha OSHMA-të në kujtesë parimet ligjore dhe etike që duhet të ndjekin operatorët audiovizivë, mbështetur në nenin 33 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe në Kodin e Transmetimit të AMA-s.

Ankesa e paraqitur nga: **L.P.**

Subjekti audioviziv

Programi

Data

Top Channel

Fiks fare

12.12.2019

1. Përmbledhje e ankesës

Ankuesja pretendon se gjatë emisionit “Fiks Fare” të transmetuar në televizionin “Top Channel”, të datës 10.12.2019, nëna e saj ishte subjekt i një video të fshehtë. Sipas ankesës, materiali i publikuar në një kamera të fshehtë *“nuk është verifikuar, pra emisioni e ka marrë dhe e ka nxjerrë, pa bërë asnjë investigim dhe për më tepër pa ditur asgjë në lidhje me situatën, duke marrë vetëm njërën palë dhe në kontekstin që ajo palë ka pasur interes”*.

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), iu drejtua me një shkresë Bordit të Shqyrtimit të Ankesave në televizionin “Top Channel”, duke kërkuar dhënien e pretendimeve mbi rastin.

Pas marrjes së shpjegimeve nga stafi i emisionit dhe shqyrtimit me kujdes të materialeve filmike, Këshilli i Ankesave nuk konstatoi shkelje të ligjit nr.97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, apo të Kodit të Transmetimit.

Emisioni “Fiks Fare”, një emision investigativo-satirik, ka transmetuar një video të realizuar me kamerë të fshehtë, pasi ka kryer më parë investigime mbi temën e trajtuar. Trajtimi i kësaj të fundit ka qenë korrekt, profesional, duke respektuar normat ligjore dhe etike.

Seksioni

2

ANKESA ME SUBJEKT

“CENIM I TË DREJTAVE TË FËMIJËVE”

Ankesa e paraqitur nga: **Shtetasi E.C.**

Subjekti audioviziv

Programi

Data

"DigitaAlb" sh.a.

"Çufo Tv"

17.07.2019

1. Përmbledhje e ankesës

Ankuesi pretendon se reklama që u dedikohet hamburgërve të kompanisë "KFC" që transmetohet në kanalin audioviziv "Çufo Tv" përmban skena dhune dhe të papërshtatshme për fëmijët

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave, pasi shqyrtoi përmbajtjen e reklamës në fjalë, konstatoi shkelje të ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe të Kodit të Transmetimit për mediat audiovizive. Reklama përmbante skena të dhunshme me ekspozim të armëve të zjarrit prandaj Këshilli i Ankesave vlerësoi se transmetimi i saj në një kanal audioviziv të dedikuar për fëmijë mund të dëmtojë zhvillimin fizik, mendor ose moral të tyre. Sa më sipër, AMA kërkoi nga shoqëria "Digit-Alb" sh.a. ndërprerjen e transmetimit të këtij versioni të reklamës për kompaninë "KFC".

Ankesa e paraqitur nga: **SH.H.**

Subjekti audioviziv _____

"ABC News"

Programi _____

"ABC Story"

Data _____

15.07.2019

1. Përmbledhje e ankesës

Ankuesi pretendon se në emisionin "ABC Story" është përfolur me shpifje denigruese organizata që ai drejton "Diplomatic Mission Peace and Prosperity" duke dëmtuar imazhin e institucionit.

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave, pasi shqyrtoi emisionin përkatës vijoi trajtimin e ankesës duke kërkuar nga Bordi i Shqyrtimit të Ankesave dhe televizioni "ABC News" paraqitjen e pretendimeve lidhur me ankesën e sipërcituar. Gjatë shqyrtimit të materialit filmik të emisionit "ABC Story", Këshilli i Ankesave nuk konstatoi shkelje të ligjit Nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar si dhe të parimeve të Kodit të Transmetimit. Këshilli i Ankesave vlerësoi se emisioni i sipërcituar mbështetet në dokumente të publikuara online dhe në dokumente zyrtare të autoriteteve publike të huaja siç rezultojnë dhe nga vendimi i Gjykatave Amerikane, në përmmbushje të detyrimit ligjor të OSHMA-ve për informimin e publikut dhe në respektim të lirisë së shtypit. Këshilli i Ankesave konstatoi se raportimet gjatë emisionit janë brenda parimeve të Kodit të Transmetimit dhe në respektim të Ligjit nr.97/2013.

Ankesa e paraqitur nga: **Agjencia Kombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve**

Subjekti audioviziv

Programi

Data

Klan TV

Stop

18.10.2019

1. Përmbledhje e ankesës

Agjencia Kombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve ngriti shqetësimin mbi intervistimin e një të miture në emisionin Stop në TV Klan e cila dyshohej se ishte shfrytëzuar për prostitucion. Sipas ankesës, intervistimi i vajzës mund të sjellë dëmtime në shëndetin dhe integrimin e saj.

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave shqyrtoi me kujdes materialet filmike të transmetuara gjatë emisionit dhe konstatoi se fytyra e 16-vjeçares është e mbuluar në të gjitha momentet kur është transmetuar. Ndërsa informacioni i transmetuar, në gjykimin e Këshillit, përbën interes publik.

Duke pasur parasysh edhe natyrën investigative të emisionit, temën e trajtuar që përbën në vetvete një plagë sociale, Këshilli i Ankesave çmon se, përgjithësisht përmbajtja e transmetuar nga emisioni “Stop” u është përmbajtur normave ligjore dhe etike. Kodi i Transmetimit sanksionon se “Shpërndarja e informacionit tek publiku, duke përfshirë këtu edhe

fotografitë për jetën private të individëve pa pëlqimin e tyre, është e pranueshme vetëm nëse një interes i ligjshëm publik tejkalon të drejtën e tyre për privatësi ose kur materiali në fjalë duhet të publikohet në interes të publikut, duke e tejkaluar të drejtën e privatësisë...” (Seksioni 3 – E drejta për privatësi dhe mbrojtjen e të dhënave personale”.

Në vlerësimin e Këshillit të Ankesave, në këtë rast, gazetari ka zbatuar standarde të larta profesionale, duke e paraqitur informacionin në mënyrë të drejtë dhe objektive, sikurse e parashikon Kodi i Transmetimit për rastet kur përfshijnë zbulimin e aspekteve të jetës private ose të të dhënave personale.

Duke vlerësuar shqetësimin e Agjencisë, në përmbajtjet audiovizive konstatojmë përmirësim të dukshëm, veçanërisht në rastet e raportimeve ku janë të përfshirë fëmijët. Në çdo rast konstatimi të shkeljes së ligjit nr.97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, apo të Kodit të Transmetimit, AMA ka ndërmarrë masat dhe sanksionet e parashikuara ligjore.

Seksioni

3

ANKESA ME SUBJEKT

TË

NDRYSHËM

Ankesa e paraqitur nga: **E.F.**

Subjekti audioviziv

Mediat audiovizive

Programi

Të ndryshme

Data

07/09/2019

1. Përmbledhje e ankesës

Ankuesi pretendon se përdorimi i fjalëve të huaja në mediat audiovizive “po shpërftyron dhe rrezikon gjuhën shqipe”

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave e vlerësoi shqetësimin e ngritur nga ankuesi duke i kujtuar se respektimi i standartit të gjuhës shqipe në transmetimet audiovizive është vazhdimisht në vëmendjen e Autoritetit të Mediave Audiovizive si element kyç në formimin gjuhësor e kulturor të moshave të reja. AMA ka organizuar tryeza diskutimi për këtë temë, në shumë rrethe të vendit, në përpjekje për të sensibilizuar operatorët audiovizivë për respektimin e standartit të shqipes së folur dhe të shkruar në median audio dhe audiovizive. Këshilli i Ankesave ka konstatuar përmirësim nga viti në vit sa i përket respektimit të gjuhës standarde shqipe në transmetimet audiovizive, por duke e konsideruar një proces dinamik, ka ende probleme dhe vështirësi që lidhen me formimin gjuhësor të gazetarëve apo të mungesës së redaktorëve e korrektorëve në redaksitë e operatorëve AMA po e ndjek me përparësi këtë problem, duke u kujtuar vazhdimisht operatorëve audiovizivë respektimin rigoroz të standartit të folur dhe të shkruar të shqipes në përmbajtjet audiovizive.

Ankesa e paraqitur nga: **E.F**

Subjekti audioviziv _____

Të gjitha

Programi _____

Të gjitha

Data _____

09.10.2019

1. Përmbledhje e ankesës

Ankuesi ngre shqetësimin mbi shtrembërimin e gjuhës shqipe në transmetimet audiovizive, fjalorin e autoriteteve publike në këto transmetime dhe kërkon vëmendjen e Autoritetit të Mediave Audiovizive ndaj kësaj çështje.

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave informoi ankuesin se kjo çështje është vazhdimisht në vëmendje të Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA).

Autoriteti, duke e konsideruar me rëndësi respektimin e standardit të gjuhës shqipe në transmetimet audiovizive si element kyç në formimin gjuhësor e kulturor të moshave të reja, e ka përfshirë këtë çështje në objektivat e tij kryesorë.

Gjatë vitit të kaluar, AMA ka organizuar tryeza diskutimi për këtë temë, në shumë rrethe të vendit, në përpjekje për të sensibilizuar operatorët audiovizivë për respektimin e standardit të shqipes së folur dhe të shkruar në median audio dhe audiovizive.

Në këto tryeza diskutimi, AMA ka prezantuar rezultatet e monitorimit të transmetimeve të televizioneve kombëtare dhe të disa televizioneve informative të Tiranës, ka evidentuar dhe trajtuar me shembuj ilustrues problematikat, dukuritë dhe rastet kryesore të shmangieve nga norma gjuhësore e shqipes, gabimet sintaksore e përdorimi i panevojshëm i fjalëve të huaja që vihen re në programet

audiovizive të televizioneve kombëtare si dhe gabimet drejtshkrimore në titrat e televizioneve informative.

Për hir të së vërtetës, konstatojmë përmirësim nga viti në vit sa i përket respektimit të gjuhës standard shqipe në transmetimet audiovizive, por duke e konsideruar një proces dinamik, ka ende probleme dhe vështirësi që lidhen me formimin gjuhësor të gazetarëve apo të mungesës së redaktorëve e korrektorëve në redaksitë e operatorëve etj.

Nga tryezat e diskutimit, që u shtrinë thuajse në të gjitha qarqet në vend, u arrit në përfundimin se, për respektimin e standardit letrar të shqipes në transmetimet audiovizive, përveç sensibilizimit të operatorëve dhe opinionit publik, duhet të mendohet për sanksione konkrete, qoftë përmes dispozitave ekzistuese në ligjin për median dhe në Kodin e Transmetimit të AMA-s, qoftë përmes amendimeve e shtesave të domosdoshme ligjore.

AMA po e ndjek me përparësi këtë problem, duke u kujtuar vazhdimisht operatorëve audiovizivë respektimin rigoroz të standardit të folur dhe të shkruar të shqipes në përmbajtjet audiovizive.

Ankesa e paraqitur nga: **E.M.**

Subjekti audioviziv _____

Programi _____

Data _____

Të gjitha

Të gjitha

16.10.2019

1. Përmbledhje e ankesës

Ankuesi ngre shqetësimin mbi mosrespektimin e kontratës që ka lidhur me një kompani private "Albtelecom" për mos aksesim OSHMA të caktuara.

shoqëri ka me abonentët e saj, AMA ka ezauruar rolin e saj ligjor për këtë çështje, gjithsesi mbetet e angazhuar në zbatimin e ligjit për mediat audivizive në Shqipëri, mbrojtjen e interesit më të lartë publik dhe garantimin e të drejtave të konsumatorëve, përmes bashkëpunimit me institucionet përgjegjëse.

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Pas shqyrtimit të ankesës, Këshilli i Ankesave bëri me dije se; AMA ka trajtuar me përgjegjësi dhe seriozitet ankesën tuaj dhe ankesa të tjera të mëparshme për të njëjtin problem, dhe ka ndër marrë hapat e duhur për adresimin e situatës së krijuar tek institucionet që sigurojnë konkurrencën në treg për shmangien e situatave të ngjashme në të ardhmen;

AMA, në zbatim të ligjit nr. 9902, datë 17.04.2008 "Për mbrojtjen e konsumatorëve" dhe referuar Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Autoritetit të Mediave Audiovizive, ka kërkuar ndërhyrjen e këtij Komisionit të Mbrojtjes së Konsumatorit (KMK) pranë kësaj ministrie, me qëllim garantimin e të drejtave të konsumatorëve;

Me këto hapa dhe të tjerë të ndër marrë në raport me shoqërinë "Digitalb" dhe kontratën që kjo

Ankesa e paraqitur nga: **A.C.**

Subjekti audioviziv

Programi

Data

Të gjitha

Të gjitha

18.10.2019

1. Përmbledhje e ankesës

Ankuesja ngre shqetësimin mbi “ekspozimin e fëmijëve ndaj disa formave të dhunës në televizion”, duke iu referuar videove të ndryshme muzikore që transmetohen në shumë OSHMA.

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Në vijim të kësaj anekese, ankueses iu bë e ditur se gjatë vitit të kaluar, AMA u ka tërhequr vëmendjen subjekteve që transmetojnë muzikë, shoqëruar me videoklipe, me materiale të papërshtatshme dhe përmbajtje jo-etike, në shkëlqje të kërkesave të ligjit nr.97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe të Kodit të Transmetimit.

Sipas ligjit 97/2013, veprimtaria e transmetimeve audiovizive respekton “në mënyrë të veçantë të drejtat, interesat dhe kërkesat morale e ligjore për mbrojtjen e të miturve” (neni 4, pika 1, germa b). Po ashtu, në nenin 33, pika 1, germa d), sanksionohet se “ofruesi i shërbimit mediatik audioviziv duhet të respektojë rregullat e etikës dhe moralit publik...”. Këto kërkesa të ligjit janë theksuar edhe në Kodin e Transmetimi,

sipas të cilit “OSHMA-të, në programet kulturore e argëtuese... duhet të tregojnë kujdesin e duhur ndaj ndjeshmërisë së publikut dhe efekteve të programeve të tyre në zhvillimin moral, mendor e fizik të të miturve”. Kur transmetohen programe që mund të dëmtojnë fëmijët, ato duhet të paraprihen nga një paralajmërim akustik ose viziv dhe OSHMA-të duhet të mbajnë parasysh shkallën e efektit të shkaktuar, si dhe të shmangin rrezikun e varësisë ndaj televizionit dhe imitimit të modeleve.

AMA ka vlerësuar dhe vlerëson angazhimin e subjekteve audiovizive të zhanrit muzikor për promovimin e kulturës kombëtare dhe nxjerrjen në pah të krijimtarisë muzikore në gjuhën shqipe, por u ka vënë në dukje këtyre operatorëve se, ky proces argëtimi, edukimi dhe informimi duhet të jetë në përputhje me kërkesat e ligjit të sipërcituar dhe të Kodit të Transmetimit.

Reagimi i këtyre operatorëve ka qenë pozitiv dhe konstatohet se, transmetimi përmbajtjeve të papërshtatshme, jo-etike, të dëmshme për fëmijët, është zhvendosur në orët e vona të natës, duke respektuar kërkesat ligjore.

Ankesa e paraqitur nga: **Disa individë**

Subjekti audioviziv _____

Programi _____

Data _____

Top Channel

Hell's Kitchen

01.11.2019

1. Përmbledhje e ankesës

Ankuesit pretenduan për skena dhe fjalor të papërshtatshëm në emisionin reality shoë Hell's Kitchen.

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), pasi mori ankesat ndaj emisionit "Hell's Kitchen Albania", që transmetohet në televizionin "Top Channel", shqyrtoi me kujdes të gjitha materialet përkatëse filmike, përfshirë edhe emisionin e transmetuar më datë 15 tetor 2019.

Nga shqyrtimi konstatojmë se, emisionin "Hell's Kitchen Albania" është një format i njohur ndërkombëtar argëtimi ("Hell's Kitchen" ose "Kuzhina e Ferrit"), ndër më të suksesshmit në gjininë "reality shoë" në të gjithë botën. Ai ka për qëllim konkurrimin në kuzhinë të profesionistëve të rinj. "Hell's Kitchen" transmetohet në shumë televizione të vendeve perëndimore, sipas të njëjtit format të paracaktuar.

Emisioni në fjalë, i cili në Shqipëri është pjesë e patentës ndërkombëtare të "Hell's Kitchen" është një "lojë" që transmetohet në mënyrë të

drejtpërdrejtë. Ky format ka përmbajtje të paralajmëruar dhe synon që, nëpërmjet tensionit, debatit, adrenalinës gjatë lojës dhe konkurrimit, të nxisë talentin për të gatuar te profesionistët e rinj. Gjithashtu, ky format përmban ndërhyrje të teknologjisë me zë, duke censuruar fjalorin e papërshtatshëm, ndërhyrje që Këshilli i Ankesave ka konstatuar se janë të pranishme në rastet e shkeljes së etikës në komunikimin gjatë emisionit.

Autoriteti ju siguron se, në çdo rast po monitoron jo vetëm këtë emision, por çdo përmbajtje audiovizive dhe, në rast konstatimi të shkeljes së ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ose të Kodit të Transmetimit, do të marrë sanksionet e parashikuara ligjore.

Ankesa e paraqitur nga: **I.K.**

Subjekti audioviziv

Programi

Data

Ora News

Emisioni Boom

02.11.2019

1. Përmbledhje e ankesës

Ankuesi pretenduan se emisioni Boom në Ora News ka transmetuar çështjen e një prone në mënyrë jo të drejtë dhe shpreset se nuk është i balancuar. Sipas tij, pretendimet e palës tjetër për pronësinë e pronës nuk janë marrë parasysh nga ana e televizionit. Ankuesi pretendon se ka kërkuar nga emisioni të drejtën e përgjigjes për të paraqitur pretendimet e tij mbi çështjen e trajtuar, pas pretendimeve që ka dhënë pala tjetër.

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive i kërkoi televizionit Ora News ti japë të drejtën e përgjigje ankuesit për të dhënë pretendimet e tij.

Referuar neni 53 të ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe rregullores "Mbi procedurat për shqyrtimin e ankesave nga Këshilli i Ankesave dhe të drejtës së përgjigjes", ankuesit duhet t'i jepet mundësia që, në të njëjtin emision të parashtrojë pretendimet e tij, qoftë me shkrim apo me regjistrim audioviziv. Konkretisht, neni 53, pika 6, përcakton:

"OSHMA-ja, brenda 10 ditëve nga marrja e kërkesës, vendos për ushtrimin ose refuzimin e së drejtës së përgjigjes dhe për këtë njofton me shkrim kërkuesin".

Në rast refuzimi të kësaj kërkesë për ushtrimin e të drejtës së përgjigjes të ankuesit, duhet të paraqisni me shkrim arsyet e këtij refuzimi pranë Këshillit të Ankesave. Pika 10 e neni të sipërcituar parashikon që "Këshilli i Ankesave, brenda 15 ditëve nga paraqitja e një ankese për refuzimin e së drejtës së përgjigjes nga një OSHMA, shqyrton çështjen dhe, nëse e gjen të drejtë ankesën e bërë, i kërkon OSHMA-së korrigjimin e fakteve dhe informacioneve, në lidhje me personin e interesuar, në një mënyrë të ngjashme dhe kohë të njëjtë me atë të transmetimit objekt ankese, brenda 7 ditëve nga marrja e njoftimit". Ndërsa pika 14 e të njëjtit nen, sanksionon: "Kur Këshilli i Ankesave vëren se OSHMA-ja nuk i ka përmbushur detyrimet, sipas pikës 10 të këtij neni, njofton AMA-n. Kjo e fundit vendos në bazë të sugjerimit të Këshillit të Ankesave për rastin konkret".

Ankesa e paraqitur nga: **A.M.**

Subjekti audioviziv _____

Klan Tv

Programi _____

Zonë e Lirë

Data _____

06.12.2019

1. Përmbledhje e ankesës

Ankuesi pretendon se gjatë emisionit “Zonë e Lirë” të transmetuar në televizionin “Klan”, ftohet një personazh që pretendon se shëron sëmundje. Sipas tij, individ i njohur si Ruzhdi Metani u bën thirrje njerëzve të ndërpresin kurat mjekësore.

ofron një mjekësi alternative për të sëmurët me kancer.

Duke pasur parasysh që OSHMA-ja mbetet e hapur për mendime të ndryshe, të cilat garantojnë fjalën e lirë, Këshilli i Ankesave mendon se emisioni dhe përmbajtja nuk kanë shkelur ligjin e sipërcituar dhe Kodin e Transmetimit. Në lidhje me pasoja të mundshme penale për të cilat ju pretendoni, duhet t’u drejtoheni institucioneve përkatëse.

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) shqyrtoi ankesën në lidhje me emisionin “Zonë e Lirë” të transmetuar në Televizionin Klan. Pas shqyrtimit të pamjeve filmike dhe pretendimeve të shprehura nga ana e televizionit mbi rastin në fjalë, Këshilli i Ankesave nuk vëren shkelje të Ligjit nr.97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar apo të Kodit të Transmetimit.

Pas shqyrtimit të pamjeve filmike, shtetasit Ruzhdi Metani i është ofruar mundësia të flasë mbi një model të ri mjekësie alternative. Drejtuesi i emisionit ka kërkuar edhe mendime alternative nga mjekë të njohur dhe drejtues shkencorë për të trajtuar tezën e të ftuarit në studio që pretendon se

Seksioni

4

ANKESA ME SUBJEKT

ANKESA TË RRËZUARA

Ankesa e paraqitur nga: **V.P.**

Subjekti audioviziv

Programi

Data

Të gjitha

Edicionet informative

10.10.2019

1. Përmbledhje e ankesës

Ankuesja pretendon se në disa media audiovizive dhe faqe internet online (portale), emri juaj “është përdorur pa asnjë provë ligjore dhe pas asnjë fakt, duke denigruar jo vetëm personalitetin, por duke rrezikuar dhe karrierën time”.

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), pasi shtyroi rastin, bëri me dije se ankesa është jashtë objektivit të punës të Këshillit të Ankesave, që përcaktohet qartësisht në nenin 20 të ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar: “Objekti i punës së Këshillit të Ankesave është mbikëqyrja e zbatimit të Kodit dhe rregulloreve të miratuara nga AMA, që kanë të bëjnë sidomos me respektimin e dinjitetit e të drejtave të tjera themelore të njeriut, në mënyrë të veçantë mbrojtjen e të miturve, të drejtës për informacion dhe sensibilizimit të opinionit publik, lidhur me respektimin e normave morale dhe etike në programet e ofruesve të shërbimeve audiovizive”.

Sa u përket mediave audiovizive:

Të gjitha kronikat informative, të

cilave u referoheni në ankesën tuaj, janë transmetuar në fillim të muajit maj 2019. Më konkretisht, lajmi përkatës në televizionin “Fax News” është transmetuar më datë 07.05.2019, në televizionin “ABC News” është transmetuar më datë 08.05.2019, ndërsa në televizionin “Vizion +” është transmetuar më datë 09.05.2019.

Bazuar në ligjin nr.97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, “Ankesa duhet të paraqitet në formë të shkruar në Këshillin e Ankesave brenda 30 ditëve nga data e transmetimit, ose kur në rastin e dy ose më shumë transmetimeve të lidhura me njëra-tjetrën, nga data e transmetimit më të vonë” (neni 52, pika 2), ankesa juaj nuk mund të trajtohet, pasi është jashtë afatit ligjor.

Ankesa e paraqitur nga: **M.S.**

Subjekti audioviziv _____

Vizion Plus

Programi _____

Edicioni iformativ

Data _____

08.12.2019

1. Përmbledhje e ankesës

Ankuesja pretendon se në disa faqe online dhe në edicionin informativ të televizionit Vizion Plus është transmetuar një kronikë ku ajo përmendet përmes disa të dhënave të paverifikuara.

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) shqyrtoi ankesën dhe iu drejtua për pretendime televizionit Vizion Plus. Pas marrjes së këtyre pretendimeve, Këshilli i Ankesave informoi ankuesen se publikimet në mediat online (faqe interneti, rrjete sociale etj) janë jashtë objektivit të punës të përcaktuar nga ligji për Autoritetin e Mediave Audiovizive.

Referuar ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, konkretisht neni 2, "Fusha e zbatimit", sanksionohet se "Ky ligj zbatohet për transmetimet audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre. Ky ligj nuk zbatohet për median e shkruar".

Gjithashtu, televizioni Vizion Plus nuk kishte transmetuar asnjë prej këtyre pretendimeve.

MM

drejtave të fës
Në adresën
Audiovizive
m bërritur
whenan men
prej të cil
peson ka të d
të pyesë, të m
mendime dhe
përmes radios
të komunikim
procedure tjet



Adresa: Rruga "Papa Gjon Pali II", Nr. 15, Kufia Postare 1010, Tiranë.

Cel: +355 67 303 3000

e-mail: Info@ama.gov.al

www.ama.gov.al